



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 238, Datë 02.11.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMI I GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË MODELIT TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPUTHJE ME NENET 67 (1) DHE 70 (1) TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2017/1485 TË DATËS 02 GUSHT 2017 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 19, pika 1, gërma f dhe nenit 26 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 02.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 02 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- OST sh.a me shkresën nr. 7136 Prot., datë 15.10.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 02 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar përkatësisht nenet 56 dhe 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE-s nr.186 dt. 10/11/2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 25 të dokumentit origjinal.
- Dokumenti vjen nga OST sha në vijim të komunikimit Nr. 3886 prot. datë 25.05.2018 me objekt “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 188, Datë 20.08.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë të

Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe propozuar për miratim si akt më vete.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Dokumenti i përbërë nga 25 nene saktëson mënyrën e krijimit të modeleve individuale të rrjetit nga secili OST, të dhënat që duhet të përmbajnë modelet përfshi topologjinë, ngarkesën, gjenerimin si dhe mënyrën e bashkimit të këtyre modeleve në një të vetëm, nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel Evropian analiza e sigurisë me qëllimin përcaktimin dhe eliminimin e kongjestioneve, për operimin optimal të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Gjithashtu dokumenti përcakton krijimin e një Mjedisi të të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E i cili do të shërbejë si pikë referimi ku të gjithë OST-të do të jenë të detyruara të venë në dispozicion dhe të kenë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm për krijimin e modeleve individuale të rrjetit.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 02 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike” (Bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

KRYETARI

PETRIT AHMETI